

VENDIM
Nr. 322, datë 18.5.2022

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA BELSH, TË PRONËS NR. 306, ME EMËRTIM “ISH-REPARTI USHTARAK NR. 7040 (BK DHE GRUP ARTILERIE)”, ME VENDNDODHJE NË TROJAS, BELSH, ELBASAN, ZONA KADASTRALE 3647, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 886, DATË 3.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BELSH, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Belsh, të pronës nr. 306, me emërtim “Ish-repart ushtarak nr. 7040 (BK dhe grup artilerie)”, me vendndodhje në Trojas, Belsh, Elbasan, zona kadastrale 3647, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e “Qendrës për Rikuperim Riciklim Belsh”.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 306, me emërtim “Ish-repart ushtarak nr. 7040 (BK dhe grup artilerie)”, me vendndodhje në Trojas, Belsh, Elbasan, zona kadastrale 3647, sipas planrilevimit, dhe të shtohet në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 886, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Belsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Belsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

Prona nr.306 "Ish Rep. Usht. nr.7040 (bk dhe Gr AT)", Trojas, Belsh, Elbasan

PRONARI SHTET MM (Forca Tokësore)

DATË 14.09.2021

QËLLIMI: Transferim

VENDNDODHJA

Bashkia BELSH

DVASHK ELBASAN

Nr.Pasurisë 215

Z.K 3647

Indeksi i Hartës K-34-112-(14-A)

TE DHËNAT E PASURISË

Lloi i pasurisë

Sip e pasurisë 12 414.6m² Sip e gjurmës së ndërtimit


Nr. kateve

Nr. pemeve

Nord = 4539615.44
East = 491866.13

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4539615.44
East = 492306.04



Nord = 4539264.37

East = 491866.13

SH 1: 2500

METRA

Nord = 4539264.37

East = 492306.04

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			301/1	K51726024H
2	Lindje			213, 212/1	
3	Jug			212/1/1	
4	Perëndim			212/18/1	

REALIZOI PËR IGJIU

Specialist Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU

DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor.

Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Shefit të Shtabit të

Përgjithëm i FA nr.5980/1, datë 30.08.2021 bazuar në dokumentacionin hartografik

arkivor, orto foto të vitit 2015-2016 e certifikuar nga ASGU.

PRONARI: SHTET MM (Komanda e Forcës Tokësore)

MIRATOHET

KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE

Gjeneral Brigade Arben KINGJI

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti

DVASHK

Nënshkrimi

KONFIRMOI

Përgjegjësi/Drejtori

Nënshkrimi/ Vula